



*Republika e Kosovës*  
*Republika Kosova/ Republic of Kosovo*  
*Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragash Municipality*

*Datë: 13.05.2026*

*Dragash*

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**Komuna e Dragashit**  
**Opština Dragaš**

*02* Nr. Br. 400/09-9082/26  
14.05 2026  
**Dragash - Dragaš**

Në bazë të nenit 58, ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-40, dhe nenit 12 të rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve 04/2017, Kryetari i Komunës, *nxjerr këtë:*

## **V E N D I M**

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare për projekte të organizatave jo - qeveritare në **fushën e kulturës.**

### **I**

Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nën programit 85009/0820.

### **II**

Mjetet e përmendura në nenin I do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

### III

Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:

1. Teksti i thirrjes publike
2. Udhëzimet për aplikantët
3. Formularët e aplikimit
4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

Formularët e aplikimit, referuar paragrafit të këtij neni janë:

1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
3. Forma e deklaramit të mungesës së fondeve të dyfishta
4. Forma e deklaramit të konfliktit të interesit
5. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
6. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.
7. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatim

Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

### IV

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (<https://kk.rks-gov.net/dragash/>)

## V

Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

1. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
2. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

## VI

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit bie vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

## VII

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit



*Kryetari i Komunës*  
*Baxhet Xheladini*



*Republika e Kosovës*  
*Republika Kosova/ Republic of Kosovo*  
*Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragash Municipality*  
*Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport*

*Datë: 13.05.2026*

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
*Dragash*  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**Komuna e Dragashit**  
**Opština Dragaš**

*11* Nr. Br. 400/02-9098/26  
14.05.2026  
**Dragash - Dragaš**

**THIRRJE PUBLIKE**

Të gjitha Organizatave Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Dragashit, programi i punës i së cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës dhe që përfshijnë aktivitete të realizuara në Komunën e Dragashit, të aplikojnë për mbështetje financiare:

▪ **NË FUSHËN E KULTURËS**

- **DITËT E MËRGATËS**

*( Organizimi i një manifestimi në pjesën e Opojës dhe organizimi i dy manifestimeve në pjesën e Gorës)*

- **FESTIVALI BALLKANIK I FOLKLORIT TË VALLËVE**  
**“OPOJA VALLËZON”**

**Vlerësimi:**

Vlerësimi profesional do të bëhet nga komisioni profesional prej 5 anëtarësh, të cilët do t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim dhe sipas rregullores për kushtet, Kriteret për Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

**Vlerësimi do të bëhet sipas:**

1. Plotësimi të kushteve administrative të aplikimit
2. Ndërlidhjes me objektivat e thirrjes
3. Kapacitetit të dëshmuar organizativ dhe menaxhues
4. Vazhdimësisë së realizimit të programit për afirmimin ndërkombëtarë të Komunës së Dragashit
5. Cilësisë së projektit
6. Originalitetit të projektit

**Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë:**

1. Formulari i aplikacionit për projekt/ program
2. Formulari i propozim-buxhetit
3. Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë
4. Formulari për konflikt interesi
5. Dokumenti i identitetit (fotokopje)
6. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së dhe Numri Fiskal (fotokopje)
7. Konfirmim nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit
8. Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore ndaj ATK-së, jo më të vjetër se 6 muaj
9. Dëshmi të implementimit projekteve/ programeve të ngjashme

Formulari për aplikim mund të merret në Web-faqen e Komunës dhe mund të dorëzohet nga **13.05.2026 deri më 03.06.2026** (15 ditë punë). Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

**Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dhe CD duhet të dorëzohen te Zyra e Protokollit (Arkivi) Nr. 1, në ndërtesën e Komunës së Dragashit, për: Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport.**

**Aplikimet**

1. **OJQ-të në kuadër të kësaj thirrje mund të aplikojnë më së shumti me një projekt.**
2. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Dragashit dhe të cilat merren me aktivitete në fushën e kulturës, rinisë e turizmit.
3. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e aplikimit.

4. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovë dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë të përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Dragashit- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
5. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantet, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Dragashit.
6. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

**Vërejtje:**

Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave. Për çdo informatë dhe për të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në Drejtorinë për Kulturë, Rini e Sport.

*Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport*

*Drejtoresha*

*Liridona Misinaj*

